



Pranuar / Dorezuar Punigjen/Prodato Received/Delivered	07-07-2022	2	viti god year
Organ /Rjesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHAK	3975/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.540/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca - anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.540/2022 të datës 17.06.2022 të parashtruar nga ankuesja ne adresë banimi:

Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Ekonomisë, në çështjen juridike „konkursi konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

PËRFUNDON PROCEDIMI administrativ lidhur me ankesën A.nr.540/2020 të datës 17.07.2022 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e caktuar në pozitën e punës Zëvendësuese e Udhëheqëses së Divizionit të Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë, sipas vendimit të datës 14.04.2021 me nr.965, me datë 17.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3560/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 25.05.2022 me numër të protokollit 1210 të Njesisë së Burimeve Njerëzore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 21.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Ekonomisë. Ndërsa me datë 24.06.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 3684/2022 nga organi i punësimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa e ankueses e datës 17.06.2022 me numër protokollit 3560/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopja e konkursit për pozitën Udhëheqës i Auditimit të Brendshëm; CV e

ankueses; Letër prezantim e datës 10.05.2022 ; Diploma e datës 31.01.2011 me nr.2692 e lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës; Çertifikatë e muajit pill 2015; Licencë e datës 1.03.2015; Licencë e datës 05.09.2011; Letër rekomandimi e datës 12.05.2010; Letër reference e datës 03.10.2010; Çertifikatë e datës 09.06.2022; Çertifikatë e datës 27.11.2019; Çertifikatë e datës 08.11.2016; Çertifikatë e datës 28.09.2011; Çertifikatë e datës 23.05.2019; Çertifikatë e datës 11.11.2021; Çertifikatë e datës 04.03.2022; Çertifikatë e datës 11.12.2018; Çertifikatë e auditimit; Çertifikatë e datës 04.03.2015; Çertifikatë e datës 04.03.2022; Çertifikatë e datës 29.09.2022; Çertifikatë e datës 13.03.2022; Vendimi i datës 17.05.2022; Vendimi i datës 03.02.2020 për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës ; E-mail zyrtar i datës 23.02.2022; E-mail i datës 13.01.2022; E-mail zyrtar i datës 20.01.2022; Njësia e Auditimit të Brendshëm e vitit 2021; Njësia e Auditimit të Brendshëm e vitit 2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë te datës 30.12.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 datës 20.01.2022; Shqyrtimi i raportit përfundimtar të Auditimit të Administrimit të Përgjithshëm të procedurës së prokurimit; Procesverbal i datës 10.12.2021; Ftesë e datës 09.12.2021; Agjenda e daës 10.12.2021; Takimi i datës 02.08.2021; Ftesë e datës 22.07.2021; Rapoti i datës 04.11.2021; Procesverbal i datës 15.10.2021; Agjenda e datës 15.10.2021; Raporti për gjendjen vjetore nga Njësia e auditimit të Brendshëm i datës 21.12.2021; Ankesë e datës 23.05.2022; Vendimi i datës 25.05.2022 me nr.1210; Përgjigje në ankesë e datës 24.06.2022 me numër protokolli 3684/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Vendimi i datës 22.06.2022 për anulimin e konkursit me nr.1442; Akt emërimi datës 24.03.2011; njoftimi i datës 18.05.2022 me nr.1122; Aplikacionii datës 12.05.2022 i Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të emërimit të datës 03.09.2012; Kontrata e punës e datës 21.03.2011; Pasqyra e llogarisë së trustit; Vendimi i datës 11.12.2019 me nr.2871; Vendimi i datës 12.07.2019; Vendimi i datës 18.04.2019; Vendimi i datës 07.11.2017; Vendimi i datës 02.03.2017 i KZKA; Letër reference e datës 08.10.2010; Vërtetim i datës 09.03.2022; Kontratë e punës e datës 18.06.2001; Kontratë e punës 29.09.2000; Kontratë e punës 25.03.2001; Kontratë e datës 29.12.1999; Vendimi i datës 14.04.2021 me nr.965; letër prezantimi i datës 10.05.2022 dhe njoftimi i datës 22.06.2022 për përfundimin e verifikimit paraprak

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses, është bërë i pamundur, *sepse*:

Duke shqyrtuar ankesën e ankueses dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për objektin e njëjtë të ankesës së ankueses, me datën 22.06.2022 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë ka nxjerr vendimin me nr.1448 me të cilin ka anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364) ngritje në detyrë i publikuar me datë 19.04.2022, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë dhe për shkak të verifikimit paraprak.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 dhe nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: „ *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë.*” konstaton se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e datës 17.06.2022 të ankueses është bërë i pamundur sepse për rastin e procedurës së rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm (RN00008364) ngritje në detyrë i publikuar me datë 19.04.2022, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë me vendimin e datës 22.06.2022 ka anuluar procedurën e rekrutimit.

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesja të përfundohej procedimi administrativ.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

.Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.540/2022, datë 07.07.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankueses
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

